



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E MIRËMBAJTJES SË OBJEKTEVE PUBLIKE

Nr. _____ Prot

Shkodër, më _____.____.2026

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

PROCESVERBAL

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE TË VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

Objekti i procedurës: *Mirëmbajtje salla e Atletikës*

Kodi CPV: 50000000-5 – Shërbime riparimi dhe mirëmbajtjeje.

Fondi limit: 8,333,333 (tetë milionë e treqind e tridhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre) lekë pa TVSH.

Në mbështetje të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr. 162/2020, "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, nenit 2, pika 2, shkronja "c", dhe nenit 78, pika 2, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, Autoriteti Kontraktor Drejtoria e Përgjithshme e Mirëmbajtjes së Objekteve Publike, Bashkia Shkodër, harton këtë procesverbal për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve të veçanta të kualifikimit për procedurën e prokurimit "**Procedurë e hapur e thjeshtuar**", me objekt: "**Mirëmbajtje salla e Atletikës**", me qëllim garantimin e respektimit të parimeve të konkurrencës, trajtimit të barabartë, mosdiskriminimit, transparencës dhe proporcionalitetit, si dhe sigurimin që kriteret e vendosura të jenë në përpjesëtim me natyrën, kompleksitetin dhe vlerën e kontratës.

Specifikimet teknike dhe kriteret e veçanta të kualifikimit janë hartuar mbi bazën e kërkesave të njësisë kërkuese, preventivit, specifikimeve teknike, grafikut të realizimit të punimeve, fondit limit të miratuar, si dhe analizës së natyrës së punimeve dhe pajisjeve që përfshin objekti i prokurimit, me qëllim përzgjedhjen e operatorit ekonomik që disponon kapacitetet profesionale, teknike dhe financiare të nevojshme për realizimin me sukses të kontratës, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a) Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9 të Dokumenteve Standarde të Tenderit;
- b) Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3 të Dokumenteve Standarde të Tenderit.

Argumentimi

Kjo kërkesë është përcaktuar në mbështetje të:

- nenit 76 të Ligjit nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, lidhur me shkaqet e skualifikimit;
- nenit 82 të po këtij ligji, që parashikon përdorimin e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit si provë paraprake;
- nenit 83 të Ligjit nr. 162/2020, që rregullon sigurimin e ofertës;
- nenit 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", të ndryshuar, për Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit;
- nenit 30 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, të ndryshuar, për sigurimin e ofertës;
- Dokumenteve Standarde të Tenderit për Procedurën e Hapur të Thjeshtuar – Shërbime.

Në përputhje me nenin 82 të Ligjit nr.162/2020, Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit pranohet si provë paraprake për përmbushjen e kriterëve të kualifikimit dhe mungesën e shkaqeve të skualifikimit. Dokumentacioni provues kërkohet vetëm nga operatori ekonomik i renditur i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit ose kur kërkohet nga Autoriteti Kontraktor, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Kërkesa për sigurimin e ofertës është vendosur për të garantuar seriozitetin e ofertës dhe mbrojtjen e interesit të Autoritetit Kontraktor gjatë zhvillimit të procedurës së prokurimit, në përputhje me nenin 83 të Ligjit nr.162/2020 dhe Dokumentet Standarde të Tenderit.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Operatori ekonomik duhet të paraqesë Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9 të Dokumenteve Standarde të Tenderit.

Argumentimi

Ky kriter është përcaktuar në mbështetje të nenit 77, pika 1, shkronja "a", dhe pika 2, si dhe nenit 82 të Ligjit nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, në lidhje me nenin 26 dhe nenin 41, pika 4, shkronja "a", të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", të ndryshuar.

Nëpërmjet këtij kriteri, Autoriteti Kontraktor verifikon se operatori ekonomik është i autorizuar ligjërisht për të ushtruar veprimtarinë profesionale që lidhet me objektin e kontratës, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Në zbatim të nenit 82 të Ligjit nr.162/2020 dhe nenit 26 të VKM nr.285/2021, Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit pranohet si provë paraprake për përmbushjen e kriterëve të kualifikimit dhe mungesën e shkaqeve të skualifikimit. Dokumentacioni provues paraqitet vetëm nga operatori ekonomik i renditur i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit ose kur kërkohet nga Autoriteti Kontraktor, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe Dokumentet Standarde të Tenderit.

Kjo kërkesë është në përpjesëtim me natyrën, objektin dhe vlerën e kontratës "**Mirëmbajtje salla e Atletikës**", nuk krijon kufizime të panevojshme për pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë dhe garanton respektimin e parimeve të transparencës, proporcionalitetit, mosdiskriminimit dhe trajtimit të barabartë, të parashikuara në legjislacionin për prokurimin publik.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar

2.2.1 Për të provuar kapacitetin ekonomik dhe financiar, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare **2023, 2024 dhe 2025**, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se **40% e vlerës së përllogaritur të kontratës**, konkretisht **3,333,333.20 (tre milionë e treqind e tridhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre presje njëzet) lekë pa TVSH**.

Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse operatori ekonomik arrin vlerën minimale të xhiros në të paktën një (1) nga vitet financiare të kërkuara.

Argumentimi

Ky kriter është përcaktuar në mbështetje të nenit 77, pika 3, dhe nenit 82 të Ligjit nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, si dhe nenit 26 dhe nenit 43, pika 2, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", të ndryshuar.

Në zbatim të nenit 82 të Ligjit nr.162/2020 dhe nenit 26 të VKM nr.285/2021, përmbushja e këtij kriteri vetëdeklarohet në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, ndërsa dokumentacioni provues paraqitet vetëm nga operatori ekonomik i renditur i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit ose kur kërkohet nga Autoriteti Kontraktor.

Në përputhje me nenin 43, pika 2, të VKM nr.285/2021, autoriteti kontraktor mund të kërkojë dokumentacion që provon kapacitetin ekonomik dhe financiar të operatorëve ekonomikë, me qëllim garantimin se ata disponojnë burimet financiare të nevojshme për realizimin e kontratës.

Vlera minimale e xhiros është përcaktuar në masën 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, duke respektuar kufirin maksimal të lejuar për procedurën "Procedurë e hapur e thjeshtuar" dhe

parimin e proporcionalitetit. Kjo vlerë është në raport të drejtë me natyrën, kompleksitetin, kohëzgjatjen dhe vlerën e kontratës me objekt "Mirëmbajtje salla e Atletikës", e cila përfshin punime mirëmbajtjeje ndërtimore, elektrike, hidrosanitare, si dhe furnizim dhe vendosje pajisjesh sportive.

Përcaktimi i viteve financiare 2023, 2024 dhe 2025 është bërë në përputhje me legjislacionin në fuqi për kontabilitetin dhe raportimin financiar, duke mundësuar verifikimin e kapacitetit ekonomik dhe financiar mbi bazën e të dhënave zyrtare të operatorit ekonomik.

Kërkesa është në përpjesëtim me objektin dhe vlerën e kontratës, nuk krijon kufizime të pajustificuara për pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë dhe garanton respektimin e parimeve të transparencës, proporcionalitetit, trajtimit të barabartë dhe konkurrencës efektive.

2.2.2 Operatori ekonomik duhet të ketë shlyer të gjitha detyrimet për taksat dhe tarifat vendore për vitin **2025**, si dhe këstet e maturuara të vitit **2026**, për të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore ku ushtron aktivitet, sipas të dhënave të regjistruara në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB), në përputhje me afatet e pagesës të përcaktuara nga secila njësi e vetëqeverisjes vendore.

Dokumentacioni provues do të paraqitet vetëm nga operatori ekonomik i renditur i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit ose kur kërkohet nga Autoriteti Kontraktor, dhe duhet të vërtetojë shlyerjen e detyrimeve për taksat dhe tarifat vendore për të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore ku operatori ekonomik ushtron aktivitet sipas të dhënave të regjistruara në QKB.

Argumentimi

Ky kriter është përcaktuar në mbështetje të nenit 77, pika 3, dhe nenit 82 të Ligjit nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, si dhe nenit 26 dhe nenit 43, pika 6, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", të ndryshuar.

Kërkesa synon të verifikojë se operatori ekonomik ka përmbushur detyrimet për taksat dhe tarifat vendore në të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore ku ushtron aktivitet, sipas të dhënave të regjistruara në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB), duke garantuar se subjekti ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin fiskal në fuqi.

Përcaktimi i vitit **2025** dhe i kësteve të maturuara të vitit **2026** është bërë në përputhje me Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore", i ndryshuar, si dhe me afatet e pagesës të miratuara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore.

Dokumentacioni provues kërkohet vetëm nga operatori ekonomik i renditur i pari, në përputhje me procedurën e verifikimit të dokumenteve të kualifikimit të parashikuar nga legjislacioni për prokurimin publik.

Kërkesa është në përpjesëtim me objektin dhe vlerën e kontratës, garanton trajtim të barabartë të operatorëve ekonomikë dhe nuk kërkon shlyerjen e detyrimeve që nuk kanë arritur ende afatin ligjor të pagesës.

2.3 Kapaciteti teknik

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbime të mëparshme të ngjashme, të realizuara gjatë 3 (tre) viteve të fundit, nga data e publikimit të njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se **20% e vlerës së përllogaritur të kontratës**, konkretisht **1,666,666.60 (një milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë presje gjashtëdhjetë) lekë pa TVSH**.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dokumentacionin e mëposhtëm:

a) **Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik**, vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, objekti dhe afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku të shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

b) **Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat**, fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi

Ky kriter është përcaktuar në mbështetje të nenit 77, pika 4, të Ligjit nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, si dhe nenit 41, pika 3, dhe nenit 55, pika 4, shkronja "b", të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", të ndryshuar.

Në procedurën e hapur të thjeshtuar, autoriteti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të provojnë përvojën e mëparshme të ngjashme në një vlerë jo më të madhe se **20%** të vlerës së përllogaritur të kontratës, të realizuar gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e publikimit të njoftimit të kontratës.

Nëpërmjet këtij kriteri, Autoriteti Kontraktor synon të verifikojë se operatori ekonomik disponon përvojën e nevojshme teknike dhe profesionale për realizimin e shërbimeve objekt prokurimi, sipas standardeve të kërkuara të cilësisë dhe brenda afateve të përcaktuara në kontratë.

Dokumentacioni provues është përcaktuar në përputhje me nenin 41, pika 3, të VKM nr.285/2021, i cili rregullon mënyrën e provimit të përvojës së mëparshme të operatorëve ekonomikë nëpërmjet dokumenteve të lëshuara nga entet publike ose faturave tatimore të shitjes, sipas natyrës së kontratës së realizuar.

Vlera e kërkuar prej **20%**, konkretisht **1,666,666.60 lekë pa TVSH**, është përcaktuar në përputhje me kufirin maksimal të lejuar nga legjislacioni në fuqi dhe është në raport të drejtë me natyrën, kompleksitetin dhe vlerën e kontratës. Kjo kërkesë respekton parimin e proporcionalitetit, garanton konkurrencë efektive dhe nuk krijon kufizime të pajustificuara për pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë.

2.3.2 Licenca profesionale

Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me **licencë profesionale të vlefshme për zbatimin e punimeve të ndërtimit**, të lëshuar nga autoriteti kompetent, e cila të përfshijë minimalisht kategoritë e mëposhtme:

- **N.S-2, Niveli A** – Impiante hidrosanitare, kuzhina, lavanderi, mirëmbajtja e tyre;
- **N.S-4, Niveli A** – Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami;
- **N.S-14, Niveli A** – Impiante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni, TV etj.

Argumentimi

Ky kriter është përcaktuar në mbështetje të nenit 77, pika 4, të Ligjit nr. 162/2020 "**Për Prokurimin Publik**", i ndryshuar, si dhe nenit 41, pika 4, shkronja "**a**", të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 "**Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik**", të ndryshuar, të cilat i japin të drejtën Autoritetit Kontraktor të kërkojë dokumentacion që provon aftësinë teknike dhe profesionale të operatorëve ekonomikë, për aq sa këto kërkesa janë të lidhura dhe në përpjesëtim me objektin e kontratës.

Gjithashtu, kërkesa mbështetet në **Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 759, datë 12.11.2014, "Për licencimin profesional të individëve dhe personave juridikë që do të ushtrjnë veprimtari në fushën e studimit e të zbatimit të punimeve të ndërtimit"**, i ndryshuar, si dhe në **Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit"**, i ndryshuar.

Objekti i kontratës "**Mirëmbajtje e sallës së atletikës**" përfshin punime rifiniture ndërtimore, punime në impiantet hidrosanitare dhe punime në impiantet elektrike. Për këtë arsye, Autoriteti Kontraktor ka vlerësuar të domosdoshme kërkimin e licencës profesionale në kategoritë që mbulojnë këto punime.

Kategoritë e licencës janë përcaktuar pas analizës së preventivit, specifikimeve teknike dhe termave të referencës, duke siguruar që secila kategori të korrespondojë drejtpërdrejt me punimet që do të realizohen gjatë ekzekutimit të kontratës.

Në mënyrë konkrete:

- **N.S-2** është kërkuar për realizimin e punimeve në impiantet hidrosanitare dhe instalimet përkatëse;

- **N.S-4** është kërkuar për realizimin e punimeve të rifiniturës, suvatimeve, lysterjeve, riparimeve të muraturës dhe punimeve të tjera të përfshira në preventiv;
- **N.S-14** është kërkuar për realizimin e punimeve në impiantet elektrike dhe instalimet elektrike të objektit.

Niveli A është përcaktuar duke marrë në konsideratë natyrën, vëllimin dhe vlerën e punimeve që përfshin kontrata dhe përbën nivelin minimal të nevojshëm për realizimin e objektit të saj.

Autoriteti Kontraktor vlerëson se këto kategori licence janë të domosdoshme për garantimin e realizimit të kontratës sipas standardeve teknike dhe kërkesave të specifikimeve teknike. Kërkesa është në përputhje me parimin e proporcionalitetit, nuk vendos barriera të pajustificuara për pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë dhe garanton që operatori fitues të jetë i autorizuar ligjërisht dhe teknikisht për të kryer punimet objekt kontrate.

Lidhja ndërmjet kategorive të licencës dhe punimeve përkatëse

Kategoria	Përshkrimi sipas legjislacionit	Punimet që mbulon	Kategoria
N.S-2	Impiante hidrosanitare, kuzhina, lavanderi, mirëmbajtja e tyre	Punime hidrosanitare	N.S-2
N.S-4	Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to	Punime ndërtimore dhe rifiniture	N.S-4
N.S-14	Impiante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni, TV etj.	Punime elektrike	N.S-14

Përcaktimi i kategorive të licencës është bërë mbi bazën e preventivit, specifikimeve teknike dhe termave të referencës të hartuara nga specialistët e fushës, të cilët kanë vlerësuar natyrën e punimeve që do të realizohen gjatë zbatimit të kontratës. Kategoritë e kërkuara përfaqësojnë minimumin e nevojshëm për realizimin e objektit të prokurimit dhe janë në përputhje me parimin e proporcionalitetit.

2.3.3 Personeli inxhinierik dhe Drejtuesi Teknik

Operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë personelin inxhinierik të nevojshëm për realizimin e kontratës, si më poshtë:

- 1 (një) Inxhinier Ndërtimi;
- 1 (një) Inxhinier Mekanik;
- 1 (një) Inxhinier Elektrik.

Inxhinierët e mësipërm duhet:

- të jenë të punësuar me kohë të plotë pranë operatorit ekonomik;
- të figurojnë në listëpagesat e sigurimeve shoqërore (E-Sig) për të paktën muajin e fundit përpara datës së publikimit të njoftimit të kontratës.

Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë, të nënshkruar nga administratori i shoqërisë, nëpërmjet së cilës:

- përcakton Drejtuesin Teknik të kontratës, i cili duhet të jetë Inxhinier Ndërtimi dhe i përfshirë në licencën profesionale të shoqërisë;
- deklaron se Drejtuesi Teknik është i disponueshëm për realizimin e kontratës gjatë gjithë periudhës së zbatimit të saj.

Gjithashtu, Inxhinieri i Ndërtimit, i cili do të ushtrojë funksionin e Drejtuesit Teknik, duhet të paraqesë vetëdeklarim se është i disponueshëm për realizimin e kontratës objekt prokurimi.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9 të Dokumenteve Standarde të Tenderit.

Operatori ekonomik i renditur i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit ose kur kërkohet nga Autoriteti Kontraktor, duhet të paraqesë dokumentacionin provues si më poshtë:

- Diplomën përkatëse për secilin inxhinier;
- Kontratën individuale të punës për secilin inxhinier;
- Dokumentacionin që provon regjistrimin në listëpagesat E-Sig për muajin e fundit;
- Deklaratën e administratorit për përcaktimin e Drejtuesit Teknik dhe disponueshmërinë e tij;
- Vetëdeklarimin e Inxhinierit të Ndërtimit për disponueshmërinë e tij.

Argumentimi

Ky kriter është përcaktuar në mbështetje të nenit 77, pika 4, dhe nenit 82 të Ligjit nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, si dhe nenit 26 dhe nenit 41, pika 4, shkronja "b", të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", të ndryshuar.

Kërkesa mbështetet gjithashtu në Ligjin nr.8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar, si dhe në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e Rregullores "Për sigurinë në kantier"", të ndryshuar.

Nëpërmjet këtij kriteri, Autoriteti Kontraktor verifikon se operatori ekonomik disponon personelin inxhinierik të nevojshëm dhe të kualifikuar për realizimin e kontratës, në përputhje me natyrën, kompleksitetin dhe vlerën e saj.

Kërkesa për **Inxhinier Ndërtimi** është vendosur duke marrë në konsideratë punimet civile, rifiniturat, montimet dhe koordinimin teknik të punimeve, për të garantuar zbatimin e projektit, kontrollin e cilësisë së materialeve dhe punimeve, si dhe respektimin e specifikimeve teknike.

Kërkesa për **Inxhinier Mekanik** lidhet me realizimin dhe mbikëqyrjen e punimeve mekanike, montimin e strukturave metalike dhe elementëve mekanikë të parashikuar në preventiv dhe termat e referencës.

Kërkesa për **Inxhinier Elektrik** është vendosur për të garantuar realizimin dhe kontrollin e punimeve në impiantet elektrike dhe instalimet përkatëse, në përputhje me projektin dhe standardet teknike.

Kërkesa që Inxhinieri i Ndërtimit të ushtrojë funksionin e Drejtuesit Teknik dhe të jetë i përfshirë në licencën profesionale të operatorit ekonomik është vendosur në përputhje me legjislacionin në fuqi për zbatimin e punimeve të ndërtimit dhe synon të garantojë që punimet do të drejtohen nga një person i autorizuar dhe me përgjegjësi teknike.

Kërkesa për vetëdeklarimin e disponueshmërisë së Drejtuesit Teknik është vendosur në mbështetje të Rekomandimit nr.6732, datë 21.10.2020 të Agjencisë së Prokurimit Publik, "Mbi problematikat e konstatuara gjatë monitorimit të procedurave të prokurimit publik", me qëllim garantimin se personeli teknik i deklaruar do të jetë realisht i angazhuar gjatë realizimit të kontratës.

Në zbatim të nenit 82 të Ligjit nr.162/2020 dhe nenit 26 të VKM nr.285/2021, përmbushja e këtij kriteri vetëdeklarohet në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, ndërsa dokumentacioni provues paraqitet vetëm nga operatori ekonomik i renditur i pari ose kur kërkohet nga Autoriteti Kontraktor.

Kërkesa është në përputhje me natyrën, objektin dhe vlerën e kontratës, nuk krijon kufizime të pajustificuara për pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë dhe garanton që kontrata të realizohet nga personel teknik i kualifikuar dhe me përgjegjësi profesionale.

2.3.4 Fuqia punëtore dhe stafi zbatues

Operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë fuqinë punëtore dhe stafin zbatues të nevojshëm për realizimin e kontratës.

Numri mesatar i punonjësve të siguruar për muajin e fundit, përpara datës së publikimit të njoftimit të kontratës, duhet të jetë jo më pak se **9 (nëntë) punonjës**, të organizuar minimalisht sipas profileve të mëposhtme:

Profili	Numri minimal
Elektracist	2
Punëtor ndërtimi	3
Hidraulik	1

Marangoz	2
Shofer	1
Totali	9

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9 të Dokumenteve Standarde të Tenderit.

Dokumentacioni provues do të paraqitet vetëm nga operatori ekonomik i renditur i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit ose kur kërkohet nga Autoriteti Kontraktor.

Për elektrikistët, punëtorët e ndërtimit, hidraulikun dhe marangozët duhet të paraqiten:

- Kontrata individuale e punës;
- Dëshmi kualifikimi profesional, certifikatë ose diplomë e lëshuar nga institucione arsimore, qendra të formimit profesional ose institucione të autorizuar/licencuara sipas legjislacionit në fuqi;
- Dokumentacion që provon regjistrimin në listëpagesat E-Sig për muajin e fundit.

Për shoferin duhet të paraqiten:

- Kontrata individuale e punës;
- Leje drejtimi e vlefshme, sipas kategorisë së mjetit që do të përdoret gjatë realizimit të kontratës;
- Dokumentacion që provon regjistrimin në listëpagesat E-Sig për muajin e fundit.

Argumentimi

Ky kriter është përcaktuar në mbështetje të nenit 77, pika 4, dhe nenit 82 të Ligjit nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, si dhe nenit 26 dhe nenit 41, pika 4, shkronja "b" dhe "c", si dhe pika 8, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", të ndryshuar.

Nëpërmjet këtij kriteri, Autoriteti Kontraktor synon të verifikojë se operatori ekonomik disponon personelin e kualifikuar dhe fuqinë punëtore të nevojshme për realizimin e kontratës, në përputhje me natyrën, kompleksitetin, vëllimin e punimeve dhe afatin e zbatimit të saj.

Në zbatim të nenit 82 të Ligjit nr.162/2020 dhe nenit 26 të VKM nr.285/2021, përmbushja e këtij kriteri vetëdeklarohet në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, ndërsa dokumentacioni provues paraqitet vetëm nga operatori ekonomik i renditur i pari ose kur kërkohet nga Autoriteti Kontraktor.

Numri minimal i punonjësve është përcaktuar mbi bazën e analizës së preventivit, specifikimeve teknike, grafikut të realizimit të punimeve, afatit kontraktor prej **3 (tre) muajsh**, si dhe

normativave të punës sipas Manualit Teknik të Ndërtimit, duke marrë në konsideratë zhvillimin paralel të proceseve të punës.

Përlllogaritja e numrit minimal të personelit është kryer si më poshtë:

- **Punime elektrike:** Totali i orëve të punës sipas preventivit është **238 orë**. Përlllogaritja rezulton: $238 \div (8 \times 22 \times 3) = 0.45$ **punonjës**.

Megjithëse rezultati matematikor është më i vogël se një punonjës, duke qenë se punimet elektrike zhvillohen paralelisht me punimet e tjera dhe kërkojnë personel të specializuar, është vlerësuar e nevojshme kërkesa për **2 (dy) elektrikistë**, për të garantuar organizimin e punimeve, zëvendësimin në rast nevojë dhe përfundimin e tyre brenda afatit kontraktor.

- **Punime hidrosanitare:** Totali i orëve të punës sipas preventivit është **118 orë**. Përlllogaritja rezulton: $118 \div (8 \times 22 \times 3) = 0.22$ **punonjës**.

Për shkak të natyrës së specializuar të këtyre punimeve është kërkuar minimalisht **1 (një) hidraulik**.

- **Punime ndërtimore:** Totali i orëve të punës sipas preventivit është **862 orë**. Përlllogaritja rezulton: $862 \div (8 \times 22 \times 3) = 1.63$ **punonjës**.

Duke marrë në konsideratë zhvillimin paralel të punimeve, volumet e preventivit dhe nevojën për respektimin e grafikut të punimeve, është vlerësuar e nevojshme kërkesa për **3 (tre) punëtorë ndërtimi**.

- **Punime marangozerie:** Totali i orëve të punës sipas preventivit është **396 orë**. Përlllogaritja rezulton: $396 \div (8 \times 22 \times 3) = 0.75$ **punonjës**.

Për shkak të natyrës së punimeve dhe nevojës për realizimin paralel të tyre është kërkuar minimalisht **2 (dy) marangozë**.

- **Shoferi** është kërkuar për transportin e materialeve, pajisjeve dhe strukturave që do të montohen gjatë realizimit të kontratës, duke garantuar furnizimin e vazhdueshëm të kantierit dhe zhvillimin normal të proceseve të punës.

Numri minimal i punonjësve është përcaktuar mbi bazën e analizës së orëve të punës sipas Manualit Teknik të Ndërtimit, grafikut të realizimit të punimeve dhe mundësisë së zhvillimit paralel të proceseve të punës.

Bazuar në analizën e mësipërme, rezulton se numri minimal prej **9 (nëntë) punonjësish** përfaqëson minimumin e nevojshëm për realizimin e kontratës brenda afatit prej **3 (tre) muajsh**, duke garantuar zhvillimin paralel të proceseve të punës, respektimin e grafikut të realizimit, specifikimeve teknike dhe standardeve të cilësisë.

Kërkesa është në përpjesëtim me natyrën, objektin, vëllimin, kompleksitetin dhe vlerën e kontratës, respekton parimin e proporcionalitetit dhe nuk krijon kufizime të pajustificuara për pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë.

Gjithashtu, kërkesa për personel të kualifikuar është vendosur në përputhje me Ligjin nr.10237, datë 18.02.2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë", i ndryshuar, me qëllim garantimin që punimet të realizohen nga personel me kualifikimin e nevojshëm dhe në përputhje me kërkesat e sigurisë dhe shëndetit në punë.

2.3.5 Mjetet dhe pajisjet teknike

Operatori ekonomik duhet të disponojë ose të ketë në përdorim, nëpërmjet kontratës së qirasë ose një forme tjetër të ligjshme disponimi, minimalisht mjetet dhe pajisjet teknike të mëposhtme për realizimin e kontratës:

Nr.	Mjeti/Pajisja	Sasia minimale
1	Mjet transporti vetëshkarkues deri në 5 ton	1 copë
2	Skeleri	10 m ²
3	Autovinc deri në 2.5 ton	1 copë
4	Pajisje të ndihmës së shpejtë	1 set

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9 të Dokumenteve Standarde të Tenderit.

Operatori ekonomik i renditur i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit ose kur kërkohet nga Autoriteti Kontraktor, duhet të paraqesë dokumentacionin provues si më poshtë:

Për mjetet e regjistruara në regjistrat publikë:

- Lejen e qarkullimit;
- Certifikatën e kontrollit teknik (kur është e aplikueshme);
- Policën e sigurimit të vlefshme;
- Certifikatën për transport mallrash brenda vendit, kur kërkohet nga legjislacioni në fuqi.

Për mjetet që nuk regjistrohen në regjistrat publikë:

- Dokument që provon pronësinë (akte zhdoganimi, faturë tatimore blerjeje ose dokument tjetër ekuivalent).

Për mjetet e marra me qira:

- Kontratën e qirasë, të vlefshme gjatë periudhës së realizimit të kontratës;
- Dokumentacionin e pronësisë ose të regjistrimit të mjetit, sipas natyrës së tij.

Argumentimi

Ky kriter është përcaktuar në mbështetje të nenit 77, pika 4, dhe nenit 82 të Ligjit nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, si dhe nenit 26 dhe nenit 41, pika 4, shkronja "ç", dhe pika 6, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", të ndryshuar.

Nëpërmjet këtij kriteri, Autoriteti Kontraktor verifikon se operatori ekonomik disponon mjetet dhe pajisjet teknike të nevojshme për realizimin e kontratës, të cilat mund të jenë në pronësi ose në përdorim, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Në zbatim të nenit 82 të Ligjit nr. 162/2020 dhe nenit 26 të VKM nr. 285/2021, përmbushja e këtij kriteri vetëdeklarohet në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, ndërsa dokumentacioni provues paraqitet vetëm nga operatori ekonomik i renditur i pari ose kur kërkohet nga Autoriteti Kontraktor.

Përcaktimi i llojit dhe numrit të mjeteve është bërë mbi bazën e analizës së preventivit, specifikimeve teknike, termave të referencës dhe grafikut të realizimit të punimeve, duke marrë në konsideratë nevojat reale për ekzekutimin e kontratës.

Konkretisht:

- **1 mjet transporti vetëshkarkues deri në 5 ton** kërkohet për transportin e materialeve të ndërtimit, pajisjeve, elementeve konstruktive dhe largimin e mbetjeve të krijuara gjatë realizimit të punimeve.
- **10 m² skeleri** kërkohen për realizimin në kushte sigurie të punimeve në lartësi, montimeve dhe punimeve të rifiniturës, sipas zërave të preventivit.
- **1 autovinc deri në 2.5 ton** kërkohet për ngritjen, lëvizjen dhe montimin e elementeve dhe pajisjeve me peshë, në përputhje me kërkesat teknike të objektit.
- **1 set pajisje të ndihmës së shpejtë** kërkohet për garantimin e kushteve minimale të sigurisë dhe ndërhyrjes së menjëhershme në rast aksidenti gjatë realizimit të punimeve, në përputhje me legjislacionin për sigurinë dhe shëndetin në punë.

Numri dhe lloji i mjeteve janë përcaktuar si minimumi i nevojshëm për realizimin e kontratës, në përputhje me natyrën, vëllimin dhe kompleksitetin e punimeve. Kërkesa respekton parimin e proporcionalitetit, nuk krijon kufizime të pajustifikuara për pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë dhe garanton që operatori ekonomik fitues të disponojë kapacitetin teknik të nevojshëm për realizimin me sukses të kontratës.

II. Argumentimi i Specifikimeve Teknike

Specifikimet teknike janë hartuar në përputhje me nenin 36 të Ligjit nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, si dhe nenin 40, pika 2, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", të ndryshuar.

Specifikimet teknike janë përgatitur duke u bazuar në nevojat reale të Autoritetit Kontraktor, projektin, preventivin, termat e referencës dhe kushtet ekzistuese të Sallës së Atletikës, ku do të realizohen punimet objekt kontrate.

Kërkesat teknike janë përcaktuar në mënyrë të tillë që të garantojnë realizimin e punimeve sipas standardeve të kërkuara të cilësisë, funksionalitetit, sigurisë dhe jetëgjatësisë, duke siguruar njëkohësisht konkurrencë të hapur dhe trajtim të barabartë të operatorëve ekonomikë.

Specifikimet teknike lidhen drejtpërdrejt me zërat e preventivit dhe përfshijnë punime ndërtimore, punime rifiniture, instalime elektrike, instalime hidrosanitare, punime mekanike, furnizim dhe montim pajisjesh, si dhe çdo punim tjetër të parashikuar në dokumentacionin teknik të procedurës.

Materialet dhe pajisjet që do të përdoren gjatë realizimit të kontratës duhet të jenë të reja, të papërdorura më parë, në përputhje me standardet shqiptare ose standardet europiane të zbatueshme, si dhe me specifikimet teknike të projektit dhe preventivit.

Punimet do të realizohen në përputhje me:

- projektin teknik;
- specifikimet teknike;
- preventivin;
- termat e referencës;
- kushtet teknike të zbatimit të punimeve të ndërtimit;
- legjislacionin në fuqi në fushën e ndërtimit dhe sigurisë në punë.

Në hartimin e specifikimeve teknike nuk janë përdorur marka tregtare, emërtime prodhuesish, patente, origjinë ose burime specifike që kufizojnë konkurrencën. Në rastet kur përshkrimi i ndonjë materiali, pajisjeje ose standardi teknik është bërë duke iu referuar një marke, tipi ose standardi të caktuar, ai duhet të kuptohet gjithmonë i shoqëruar me shprehjen "**ose ekuivalente**", në përputhje me nenin 36 të Ligjit nr. 162/2020.

Specifikimet teknike janë hartuar në mënyrë proporcionale me objektin e kontratës "**Mirëmbajtje Salla e Atletikës**", nuk krijojnë pengesa të pajustifikuara për konkurrencën dhe garantojnë trajtim të barabartë të operatorëve ekonomikë, në përputhje me parimet e transparencës, proporcionalitetit, mosdiskriminimit dhe konkurrencës efektive të parashikuara në legjislacionin për prokurimin publik.

